



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Kuvendi Komunal-Junik

Nr. 01-02/22

Datë: 08. 06. 2022, ora 15⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbi Mbledhjen e Dytë të Rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur më datën 08 Qershor, 2022, në orën 15⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Këshilli si në vijim:

1. Besart Tofaj-Nënkryetar i Komunës - Koordinator i KKSB-së,
2. Xhafer Lokaj-Zëvendës-komandant i Stacionit Policor në Junik,
3. Imer Krasniqi-Përfaqësues i Bashkësisë Islame,
4. Zejnepe Gaxherri-Kryesuese e Komitetit për Komunitete,
5. Xhevahire Krasniqi-Zyrtare për Barazi Gjinore,
6. Xhavit Velijaj-Drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulture, Rini dhe Sport,
7. Xhavit Gaxherri-Kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës së Junikut,
8. Arbër Gjota- Përfaqësues i Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi,
9. Shkëlzen Shehu- Përfaqësues i Emergjencave Civile Komunale,
10. Dukagjin Lllolluni -Përfaqësues nga OJQ,
11. Dervish Avni Muslijaj-“Teqja e Madhe Amë e Tarikatit Alijjei- Haletije Xhaferi”, Junik
12. Leonita Jasiqi - Përfaqësuese e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, dhe
13. Afërdita Shehu - Kryesuese e Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi,

Në këtë mbledhje munguan; Albestrim Rexhepi - Përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Arsim Shehu -Përfaqësues nga Komuniteti i Biznesit, dhe Qamil Jasiqi- Përfaqësues nga Komuniteti i Personave me Aftësi të Kufizuara.

Në këtë mbledhje morën pjesë edhe; Fatos Shala- Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe Zeqë Hebibi-Zyrtar Administrativ.

Mbledhjen e Dytë të Rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022, e shpalli të hapur koordinatori i KKSBB-së z. Besart Tofaj, i cili përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, dhe nga anëtarët Këshillit kërkoj miratimin e Rendit të Ditës si më poshtë:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut,
3. Plani i Punës për vitin 2022,
4. Raportimi mbi Covid-19 (2022), dhe
5. Të ndryshme.

Ky Rend i Ditës u miratua nga anëtarët e pranishëm në këtë mbledhje të KKSBB-së.

Pika e parë të Rendit të Ditës,
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Koordinatori i KKSBB-së z. Besart Tofaj nga anëtarët e këtij Këshilli kërkoj shqyrtimin dhe miratimin e kësaj pike. Gjatë shqyrtimit, fjalën e kërkoj z. Xhavit Gaxherri i cili tha se në **pikën e katërt** të procesverbalit nuk është cekur çështja e trotuareve dhe siguria në komunikacion. Ne kemi kërkuar në mbledhje e kaluar që trotuaret të jenë të lira për këmbësorët dhe qytetarët, pra t'u shërbejnë qytetarëve, dhe kjo të bëhet në bashkëpunim me policinë. Z. Xhavit Gaxherri tha se të njëjtën çështje në mbledhjen e kaluar e kishte ngritur edhe z. Qamil Jasiqi, i cili kishte theksuar se ai ka problem në qasjen e bizneseve dhe lokaleve të tij në lagjen Qendër në Junik, ku automjetet e qytetarëve parkohen në trotuar dhe në vend-parkingjet e lokaleve të tij. Z. Qamil Jasiqi ka kërkuar që nga policia të merren masa lidhur me rregullimin dhe sanimin e këtij problemi. Z. Xhavit Gaxherri kërkoj që këto kërkesa, pra ky citat të cekët në **pikën e katërt** të këtij procesverbali.

Z. Besart Tofaj shpjegoi se kjo ka ndodhur për shkak të mos pranisë së procesmbajtësit në këtë mbledhje, dhe për shkak të problemeve teknike gjatë incizimit të kësaj mbledhjeje të KKSBB-së, por tha se këto çështje do cekën në këtë pikë të Rendit të Ditës, ndërsa kërkoj miratimin e këtij procesverbali me ndryshimet e lartcekura.

Pika e parë e këtij Rendi të Ditës, me këto ndryshime u miratua nga të gjithë antarët.

Pika e dytë të Rendit të Ditës,
Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut

Për këtë pikë fjalën e mori Zëvendës-komandanti i Policisë në Junik z. Xhafer Lokaj i cili tha, çështja e sigurisë në Komunën e Junikut në përgjithësi është e qetë, e mirë, stabile dhe nuk ka ndonjë gjë shqetësuese. Kështu që ne veprojmë dhe zbatojmë disa plane operative dhe disa projekte, të cilat në plan të parë janë preventiva për çështjen e sigurisë në shkolla, lokale, përdorimi i armeve ilegale, e tjera.

Sa i përket sigurisë në shkollë, në çdo ditë jemi të pranishëm, sidomos në shkollën fillore nga ora 7:30-8:00, si dhe nga ora 12:00-13:00, kjo është në kuadër të planit tonë operativ. Pastaj veprojmë edhe me planin operative për drogë në shkollë, ku kemi policë civil, dhe raporte inteligjente që i dërgon regjioni me seli në Pejë.

Kemi edhe planin për parandalimin e grabitjeve dhe vjedhjeve. Situata shqetësuese kemi në Parkun Moronica, nga ku kemi informacione shqetësuese se objekti i cili gjendet aty është duke u dëmtuar. Ne bëjmë patrullime të herëpashershme aty, dhe unë kisha propozuar që mbikëqyrësi i atyre objekteve të kujdeset për identifikimin e atyre personave të cilët janë duke bërë vepra jo të mira aty. Është mirë që aty të vendosen kamera të vëzhgimit të cilat do të ndihmonin në identifikimin e personave, apo kryerësve të këtyre veprave të dëmshme. Tjetër, deri me tani nuk kemi pasur zjarr-vënie, apo zjarre, dhe mbarëvajtja e tyre deri më tani ka shkuar mirë, më ç'rast unë falënderoj edhe Komandantin e Njësisë së zjarrfikësve z. Shkëlzen Shehu për intervenim të shpejtë, së bashku me njësitin e tij.

Z. Besart Tofaj tha, lidhur me çështjen e ngritur unë do t'i adresoj kërkesat dhe do të shikoj mundësinë që në kuadër të projektit për mirëmbajtjen e kamerave të vendoset edhe aty një kamerë e vëzhgimit.

Z. Xhafer Lokaj tha, sa i përket çështjes së komunikacionit, momentalisht kemi stafin e reduktuar, ku disa nga policët tanë i kanë dërguar në kufi, për çka unë kam bërë ankesë të drejtorit të Regjionit.

Fjalën e kërkoj edhe Arbër Gjota i cili tha, unë jam kryetari i Komitetit Lokal për Siguri Publike. Ne si KLSP mbajmë mbledhje të rregullta dhe kemi bashkëpunim me policinë e komunës sonë. Unë së bashku me anëtarët e këtij Komiteti e kemi parë të arsyeshme që të fillojmë me një fushatë, e cila ka për qëllim shpërndarjen e fletushkave për bashkatdhetarët tanë që vijnë në pushime, që për synim ka vetëdijesimin e qytetarëve lidhur me mos ngasjen e shpejtë të automjeteve, mospërdorimin e armëve gjatë ahengjeve, mospërdorimin e alkoolit gjatë ngasjes së automjetit, e të tjera.

Ky projekt parasheh që fletushkat të jenë në formë flet-palosje, që në bashkëpunim me policinë t'u jepet qytetarëve.

Ne si KLSP kemi bashkëpunim të mirë me Policinë e Kosovës, respektivisht Policinë e Komunës së Junikut, kemi përfituar një projekt nga OSBE në bashkëpunim me Policinë e Kosovës. Ai projekt është marrë dhe është për sigurinë e qytetarëve të komunës sonë. Projekti ka qenë për disa "policë të shtrirë", nëpër lagjet e Komunës së Junikut, por koha me shira nuk na ka mundësuar që ky projekt të realizohet. Neve na është dashur të marrim leje në Ministrinë e Infrastrukturës, dhe kemi pasur vështirësi të tjera për realizimin e këtij projekti. Por ne për mos humbjen e këtij projekti, kemi punuar në një projekt tjetër të cilin veçse e kemi përfituar, dhe i cili është për pajisje kompjuterike, të cilat i janë dorëzuar Gjimnazit "Kuvendi i Junikut".

Ne si KLSP kemi edhe projekte tjera por presim përkrahje edhe prej Komunës për disa projekte të cilat mund t'ua përcjellë edhe në formë elektronike.

Ndërsa, shpërndarjen e këtyre fletushkave për qytetarët dhe bashkatdhetarët tanë që do të vijnë në pushime verore do ta bëjmë nëpër pikat e kontrollit së bashku me policinë.

Ne kërkojmë edhe përkrahjen e Komunës për sigurimin e këtyre fletushkave, përndryshe ne si KLSP do të vazhdojmë me realizimin e këtij projekti. Këto fletushka do të përmbajnë, kufizimin e shpejtësisë së automjeteve, mospërdorimin e armëve në ahengje, dhe mospërdorimin e alkoolit gjatë ngasjes së automjeteve.

Nënkryetari, respektivisht koordinatori i KKSBB-së z. Besart Tofaj tha, ne do ta përkrahim këtë projekt dhe bashkërisht do ta realizojmë atë.

Z. Xhavit Gaxherri tha, me vjen mirë për këtë nismë të KLSP-së, mirëpo mua me intereson të di se sa fletushka duhet dhe çfarë kosto do të ketë ky projekt.

Z. Arbër Gjota tha, ne nuk i kemi detajet e kostos, por fletushka janë rreth 1000 copë, me përmbajtjen e lartcekur.

Z. Xhafer Lokaj tha, unë e falënderoj KLSP-në, por ne si Stacion Policor në Junik, gjithherë me planin operativ operojmë në sezonin verorë, dhe paraprakisht i ftojmë pronarët e Gastronomisë, dhe i shqyrtojmë të gjitha gjërat sa u përket lokaleve të tyre, dhe kemi pasur sukses, dhe kemi pasur situatën nën kontroll gjithherë, dhe në bashkëpunim të mirë me të gjithë do t'ia dalim prapë.

Kemi pasur probleme me parkingjet, sidomos gjatë fluksit të bashkatdhetarëve tanë gjatë sezonës së pushimeve verore, por do t'ia dalim edhe kësaj.

Z. Imer Krasniqi tha, unë desha të ndërlidhem që në kuadër të ligjëratave që kemi ditën e Premte, kemi mbajtur ligjëratë që kanë të bëjnë me rrezikshmërinë në trafik. Masat parandaluese në aspektin fetare duke bashkëpunuar me Myftiun e Kosovës, ka qenë si qarkore në nivel të Kosovës, mirëpo me duket se është bukur problem të vetëdijesohet populli ynë. Policia duhet të marrë masa më të rrepta në kuptimin e veprimit, sepse është e pa tolerueshme që kamionët 30 tonësh të shkojnë me shpejtësi 60 km/h nëpër Junik. Unë e kuptoj se ne jemi një lokalitet i vogël dhe kemi njoftuesi me njeri tjetrin, mirëpo humbja e një jetë i tejkalon të gjitha këto njoftësi që kemi në mes veti. Këtë e kemi potencuar në takimin e fundit me komandantin e Policisë, dhe them që është koha për veprim dhe ndëshkim të kësaj dukurie. Unë mirëpres këtë nismë të KLSP-së dhe e cilësoj të qëlluar, dhe shpresoj që ta kalojmë sezonin verorë pa ndonjë fatalitet, së paku.

Z. Xhavit Gaxherri tha, unë propozoj që nga ky Këshill t'i drejtohet organeve komunale, Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Inspeksion, pasi që vie nga Këshilli i Prindërve të Arsimit të Komunës së Junikut. Ne si Këshill drejtues në takimin e parë që kemi mbajtur, kemi bërë analiza dhe vlerësimin e sigurisë së nxënësve dhe shkollës përreth. Ne iu kemi drejtuar Komunës me një shqetësim që ka dalë nga ai takim lidhur me rrugën që përshkon rrethin në drejtim të Vokshit, që të shikohet mundësia se sa është e mundshme të bëhet një ndërhyrje në atë rrugë, sepse ajo është shumë e ngushtë dhe lëvizja në të është shumë e madhe në të njëjtën kohë, por që fatmirësisht deri më tani nuk ka pasur ndonjë lëndim apo pësim të nxënësve apo qytetarëve. Por është mirë që autoritet të mendojnë që të rregullohet komunikacioni përgjatë asaj rrugë, sepse e shohim të arsyeshme për sigurinë në komunikacion, pavarësisht se a bëhet një apo dydrejtimëshe. Pra, kjo donë një analizë dhe

një vlerësim nga organet përkatës, dhe do të ishte mirë që deri në muajin Shtator kur fillon edhe mësimi, kjo rrugë të rregullohet.

Z. Besart Tofaj tha, kjo ka qenë në kuadër të Planit të Mobilitetit, por kjo nuk është zbatuar deri me tani. Do të përpiqemi që deri në Shtator të kemi një qasje më të sigurt për nxënësit dhe qytetarët.

Z. Xhavit Velijaj tha, unë desha të shtoj në lidhje me atë që ne kemi biseduar për çështjen e kësaj rruge e cila është shumë e ngushtë, e nivelit të tretë. Kjo është rrugë regjionale, mirëpo është duke u punuar që të bëhet një projekt detal edhe për Qendrën, që është si detyrë projektuese, ku parashihet se si do të jetë. Kjo ka mbetur si çështje e pazgjedhur që një kohë të gjatë, por në formë parciale është pak problematike sepse duhen mjete. Unë e di se me tabelë të komunikacionit ndalohen mjetet e rënda të transporti në kohë të caktuar por e cila nuk respektohet sa duhet. Ky është një problem serioz që duhet të trajtohet, dhe është në prioritet të Kryetarit dhe të Komunës që të zgjidhet, dhe besoj që ku segment i rrugës do të përfshihet në projektin e Qendrës, pra në kuadër të kësaj do të parashihet zgjidhja e asaj pjesë të rrugës sipas analizës dhe vlerësimit të eksperteve.

Pika e Tretë Rendit të Ditës, *Plani i Punës për vitin 2022*

Koordinatori z. Besart Tofaj paraqiti për shqyrtim dhe miratim Planin e Punës së KKSB-së për vitin 2022.

Z. Xhavit Gaxherri lidhur me këtë e kërkoj fjalën dhe tha, mendoj që plani i punës i përmbushë mirë fushat që jemi të thirrur !

Z. Besart Tofaj tha, Planin e punës ju ftoj ta shqyrtojme dhe mundësisht ta miratojmë, pastaj ky plan shkon në KPF dhe në Kuvend për miratim.

Ky plan pune u shqyrtua dhe u miratua nga të gjithë antarët e KKSB-së.

Pika e Katërt e Rendit të Ditës, *Raportimi mbi Covid-19 (2022)*

Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z. Fatos Shala tha, drejtorja jonë në bashkëpunim me drejtorin e QKMF-së ka përgatitur një informatë me shkrim në pika të shkurtra të cilën informatë e keni përpara. Në tre mujorin e parë të këtij viti kemi pasur një raport për Kuvendin, në të cilin raport kemi bërë përditësimet dhe ndryshimet që kanë ndodhë deri në këtë periudhë. Edhe pse kemi pasur shumë raste, gjendja ka qenë stabile, dhe në bashkëpunim me Policinë e Junikut dhe Shtabin Emergjent gjithçka ka qenë nën kontroll. Tani ka kaluar rrezikshmëria e variantit Omicron. Kemi pasur 192 raste të konfirmuara me Covid pozitiv të variantit Omicron. Në QKMF shërbimet kanë vazhduar, ndërsa rreth 40% të pacienteve janë të rrethinës, kryesisht të Komunës së Gjakovës, por çdo gjë ka qenë në nivel. Trajtimi në përgjithësi ka qenë i duhur dhe i përgjegjshëm. Janë kryer 680 testime për

Covid me PCR test, dhe ka pasur mjaftueshëm teste. Nga ato testime 130 kanë qenë nga komuna jonë dhe të tjerat nga komunat përreth.

Vaksinimi ka vazhduar por tani ritmi i vaksinimi ka rënë shumë. Me dozën e parë të vaksinuar kemi 2221, me të dytën 2140 dhe me të tretën 450 persona nga Komuna e Junikut. Krahës kësaj ka vazhdua edhe vaksinimi për gripin sezonal, ku janë vaksinuar 279 persona, ndërsa me insulina janë furnizuar 42 pacientë të rregullt.

Z. Xhavit Gaxherri pyeti se nga 192 raste që janë trajtuar, a kanë marrë trajtim hospitalizimi apo janë trajtuar në shtëpi?

Z. Fatos Shala tha, siç është cekur në raport, ne nuk kemi pasur asnjë rast hospitalizimi apo rast të konfirmuar me vdekje.

Z. Xhavit Velijaj tha, ne si shoqëri në njëfarë forme jemi çliruar në aspektin që thuajse ka kaluar gjithçka, por faktikisht nuk ka kaluar, ne jemi në pandemi. U fol që edhe masat kanë kaluar, por ato janë në efekt, dhe vendimi i fundit i qeverisë ka qenë me 31 Prill. Masat janë strikte, mirëpo tani janë liruar pak për ahengje, ekskursionet etj. Mirëpo, derisa institucionet, apo organet përgjegjëse japin sinjalin e fundit që gjithçka ka kaluar dhe nuk jemi akoma në pandemi, atëherë ne mund të themi që ta vazhdojmë jetën normalisht. Pot ne akoma nuk jemi në atë fazë.

Për shkollat që u përmenden, janë disa normativa, disa rregulla që fjalën e fundit e japin njerëzit profesionist të fushës, dhe ne duhet t'i dëgjojmë ata. Atëherë kanë qenë rekomandimet, prej mjekeve të QKMF-së këtu dhe Institutit të Shëndetësisë që duhet të kemi kujdes dhe shkollat t'u përmbahen udhëzimeve nga MASHT-i, varësisht nga rrethanat që gjendeni.

Në kohën e pandemisë ne kemi vepruar drejtë, dhe tani që është Vera, dhe pritet frekuentim më i madh i qytetarëve, pandemia do t'i ketë rreziqet e veta.

Unë mendoj që duhet të jemi të kujdesshëm, sepse rreziku akoma nuk ka kaluar.

Z. Fatos Shala tha, dua ta plotësoj pak drejtorin e Arsimit. Në fakt ne nuk e kemi shpallur përfundimin e pandemisë. Është Organizata Botërore e Mjekëve që është autoritet që analizon situatën dhe shpall përfundimin e saj. Por unë pajtohem se duhet të jemi të kujdesshëm, sidomos kur është fjala për grumbullimin e njerëzve apo ahengje e festa. Tani për tani nuk kemi raste pozitive dhe kjo na bën të ndihemi mirë, por jo edhe komod, sepse çdo ditë dëgjohen lajme se në Evropë dhe në vende tjera kanë akoma raste pozitive. Ne në Komunën e Junikut jemi mirë dhe shpresoj se do ta kalojmë mirë.

Dhe si mesazh i fundit siç e tha edhe drejtori i Arsimit, dhe Xhavit që vaksinimi mos të neglizhohet. Rekomandimi i mjekëve është që imunizimi të vazhdoj. Vaksina ka mjaftueshëm, dhe ata të cilët nuk e kanë marrë dozën e parë, të dytën, dhe të tretën të shkojnë të vaksinohen, sepse krijojnë imunitet sipas mjekëve.

**Pika e pestë e Rendit të Ditës,
Të ndryshme**

Koordinatori z. Besart Tofaj tha, unë desha t'ua jap një informacion lidhur me qenet endacak. Qeveria bashkë me Ministrinë e Pushtetit Lokal është duke përgatitur një strategji nacionale, e cila është afër finalizimit dhe besoj që këtë vit do përfundon. Komunat do të pajisen me këto dokumente dhe pastaj do mbahen dëgjime publike, dhe atëherë do ta kemi më të lehtë zgjidhjen e çështje së qenve endacakë.

Z. Imer Krasniqi tha, kjo është tema më aktuale në aspektin e sigurisë në Junik, mirëpo unë desha të di se si qëndron çështja e ujitës së tokave përmes kanalit të epërm, pra deri ku ka shkuar procesi deri me tani?

Z. Besart Tofaj tha, jeni në fazën e finalizimit të projektit nga punëkryesi, dhe besoj se për disa ditë kjo do të përfundoj.

Z. Xhavit Gaxherri tha, është mirë që rekomandimet që dalin nga ky Këshill të merren parasysh nga organet kompetente, dhe ato të zbatohen. Qëllimi është se nëse fjala nuk kthehet në veprim, atëherë rezultati do të jetë i barabartë me zero.

Z. Xhavit Velijaj tha, kjo në një farë forme është obligim që rekomandimet e KKSB-së të merren parasysh, sepse këto nuk janë çështje dëshirash, dhe këto takime kanë një kosto poashtu.

Z. Besart Tofaj tha, ne nganjëherë kemi kufizime buxhetore, mirëpo ne do të mundohemi në një mënyrë apo tjetër ta adresojmë secilën çështje.

Me kaq, koordinatori z. Besart Tofaj shpalli të mbyllur këtë mbledhje të KKSB-së.

Procesmbajtësi,


Gëzim Geci

Kryetari i Komunës, Kryesues i KKSB-së


Ruzhdi Shehu